



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. _____ Prot.

Datë ____ .12. 2017

VENDIM

Nr.29, datë 29. 12. 2017

Për

“Miratimin e strategjisë dhe planit të veprimit të AKEP për vitin 2018”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 29.12.2017, në mbështetje të nenit 114 dhe nenit 115 në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregullores së Brendshme për Funksonimin e Këshillit Drejtues (KD) të AKEP, miratuar me Vendim të KD Nr.7, datë 16. 02.2017, shqyrtoi çështjen me objekt:

- “Miratimi Startegjisë dhe Planit të Veprimit të AKEP për vitin 2018”

BAZA LIGJORE:

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 46/2015**)
3. Rregullore e Brendshme për Funksonimin e Këshillit Drejtues (KD) të AKEP, miratuar me Vendim të KD Nr.7, datë 16. 02.2017;
4. Rregullore e Brendshme e Funksonimit të Administratës së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), miratuar me Vendim të KD Nr.6, datë 16. 02.2017;

5. Urdhër nr. 1889, datë 02.11.2016 “Për raportimin e brendshëm ditor, periodik dhe të vazhdueshëm on-line në AKEP” (**Urdhër nr. 1889**)

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Projekt Plani i Veprimit të AKEP për vitin 2018 (**Dokument**);
2. Relacionin shpjegues mbi Dokumentin (**Relacion**);
3. Projekt-Aktin vendimmarrës të Këshillit Drejtues (**Projektvendim**);

si dhe:

- konsiderimi i shpjegimeve të dhëna nga relatori i çështjes dhe diskutimeve në mbledhje;

V Ë R E N:

1. AKEP është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave
2. Në kuadër të objektivave të përcaktuara rregullatore, AKEP duhet të planifikojë programin e tij të ardhshëm të aktiviteteve në përgjigje të nevojave të tregut, duke marrë parasysh prioritetet kryesore.
3. Dokumenti “Strategjia dhe Plani i Veprimit të AKEP për Vitin 2018” i paraqitur nga Kryetari i Këshillit Drejtues përmban fushat kryesore dhe prioritetet strategjike ku do fokusohet puna e AKEP gjatë vitit 2018. AKEP do të punojë që gjatë vitit 2018 të ketë progres në katër fusha kryesore nëpërmjet prioriteteve strategjike të identifikuar për secilën fushë dhe masat specifike për realizimin e tyre, pra Planin e Veprimit të AKEP për vitin 2018.
4. Ky dokument është përgatitur pas seminarit “Strategjia dhe plani i veprimit të AKEP për vitin 2018”, të organizuar nga AKEP në Shkodër më datë 19-20.12.2017, me pjesëmarrjen e punonjësve të AKEP dhe përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës si dhe ekspertë të fushës.
5. Me qëllim rritjen e transparencës dhe efikasitetit të punës së AKEP dhe komunikimit me palët e interesuara, AKEP publikon për herë të parë një dokument të tillë të vecantë për planin e veprimit për vitin pas-ardhës. AKEP do të vijojë të publikojë në muajin Dhjetor të çdo viti planin e veprimit për vitin pas-ardhës, duke synuar edhe një përfshirje më të madhe të palëve të interesuara në këtë proces.
6. Dokumenti konsideron plotësisht sa përcaktohet në pikën 2 të nenit 30 të Rregullores e Brendshme e Funksionimit të Administratës së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), miratuar me Vendim të KD Nr.6, datë 16. 02.2017, si dhe konkluzionet e

arritura në Seminarin me temë “Strategjia dhe Plani i Veprimit të AKEP për vitin 2018” zhvilluar në Shkodër datë 19-20.12.2017.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 114 të ligjit nr. 9918, ligjit nr. 46/2015 dhe nenit 19 të Rregullore e Brendshme për Funksonimin e Këshillit Drejtues (KD) të AKEP, miratuar me Vendim të KD Nr.7, datë 16.02.2017.

V E N D O S:

1. Miratimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit të AKEP për vitin 2018 sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Vendimi dhe Plani i Veprimit të AKEP për vitin 2018 të publikohet në faqen elektronike të AKEP www.akep.al.
3. Ngarkohet Kabineti dhe gjithë strukturat e AKEP për zbatimin e këtij vendimi dhe Planit të Veprimit.

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

Ilir ZELA

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**



“STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT TË AKEP PËR VITIN 2018”

(Miratuar me VKD nr.29, datë 29.12.2017)

INDEKSI I PERMBAJTJES

I. HYRJE	3
II. FUSHAT KRYESORE, PRIORITETET STRATEGJIKE DHE VEPRIMET SPECIFIKE	5
II.1 FUSHAT KRYESORE DHE PRIORITETET STRATEGJIKE	5
II.2 VEPRIMET SPECIFIKE	7
ANEKS 1: PLANI I VEPRIMIT TË AKEP PËR VITIN 2018	18

I. HYRJE

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Roli, funksionet dhe kompetencat institucionale si organ rregullator i fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar përcaktohen në legjislacionin material për komunikimet elektronike dhe shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë:

- Ligji Nr. 9918/2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe
- Ligji Nr. 46/2015, “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”.

Në kuadër të objektivave rregullatore, AKEP duhet të planifikojë programin e tij të ardhshëm të aktiviteteve në përgjigje të nevojave të tregut, duke marrë parasysh prioritetet kryesore strategjike.

Qëllimi i këtij dokumenti është që AKEP të përcaktojë fushat kryesore dhe prioritetet strategjike për vitin 2018 si dhe veprimet që do ndërmerren nga AKEP gjatë vitit 2018 për të përmbushur objektivat rregullatore të përcaktuara në legjislacionin për komunikimet elektronike dhe shërbimet postare si dhe në politikat dhe strategjitë përkatëse sektoriale të qeverisë.

Ky dokument përmban fushat kryesore dhe prioritetet strategjike ku do fokusohet puna e AKEP gjatë vitit 2018. AKEP do të punojë që gjatë vitit 2018 të ketë progres në katër fusha kryesore nëpërmjet prioriteteve strategjike të identifikuara për secilën fushë dhe masat specifike për realizimin e tyre, pra Planin e Veprimit të AKEP për vitin 2018.

Ky dokument u përgatit pas seminarit “*Strategjia dhe plani i veprimit të AKEP për vitin 2018*”, të organizuar nga AKEP në Shkodër më datë 19-20.12.2017, me pjesmarrjen e punonjësve të AKEP dhe përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës dhe ekspertë të fushës.

Me qëllim rritjen e transparencës dhe efikasitetit të punës së AKEP dhe komunikimit me palët e interesuara, AKEP publikon për herë të parë një dokument të tillë të vecantë për planin e veprimit për vitin pas-ardhës. AKEP do të vijojë të publikojë në muajin Dhjetor të çdo viti planin

e veprimit për vitin pas-ardhës, duke synuar edhe një përfshirje më të madhe të palëve të interesuara në këtë proces në vitet në vijim.

Në Kapitullin II, dokumenti përmban fushat kryesore dhe prioritetet strategjike të identifikuara për punën e AKEP për vitin 2018 dhe për një periudhë afat-mesme, si dhe përshkrimin e detajuar të veprimeve specifike sipas prioriteteve strategjike. Fushat kryesore, prioritetet strategjike, veprimet specifike dhe rezultatet e pritshme të tyre janë përmbledhur në mënyrë tabelare në Aneks 1 të këtij dokumenti.

II. FUSHAT KRYESORE, PRIORITETET STRATEGJIKE DHE VEPRIMET SPECIFIKE

II.1 Fushat Kryesore dhe Prioritetet Strategjike

Bazuar në ecurinë e sektorëve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare, problematikës së evidentuar në këto sektorë si dhe me qëllim përmbushjen e objektivave rregullatore të përcaktuara në ligjet organike për komunikimet elektronike dhe shërbimet postare si dhe në politikat dhe strategjitë përkatëse sektoriale të qeverisë, AKEP ka evidentuar katër fusha kyce ku duhet të fokusojë punën e tij gjatë vitit 2018:

1. Kushte të favorshme për Investitorët
2. Nxitje e konkurrencës së ndershme ndërmjet operatorëve të rrjeteve dhe ofruesve të shërbimeve
3. Përfitimet për konsumatorët
4. Efikasitet i brendshëm i AKEP dhe partneriteti me institucionet në vend

Për secilën prej fushave të mësipërme AKEP ka evidentuar prioritetet strategjike dhe veprimet specifike që do të ndërmerren gjatë vitit 2018 për të bërë progres në secilën prej fushave kryesore. Skema e mëposhtme përmban fushat kryesore dhe prioritetet strategjike për vitin 2018, ndërsa përshkrimi i prioritetëve si dhe veprimeve specifike që do të ndërmerren nga AKEP për vitin 2018 dhe në disa raste për një periudhë afat-mesme deri afat-gjatë janë dhënë në seksionin 2 të këtij kapitulli.

Skema 1: Fushat Kryesore dhe Prioritetet Strategjike të Punës së AKEP për vitin 2018.

1. Kushte te favorshme per Investitoret

- Rregulla te qarta dhe te qendrueshme ne kohe per zhvillimin e hapur te infrastruktures broadband.
- Nxitja e investimeve ne infrastrukturen me Fiber Optike.
- Pershpejtimi i procedurave per venien ne dispozicion te operatoreve te spektit te pershtatshem per sherbimet broadband.
- Mbeshtetja e iniciativave per zhvillim broadband ne zonat komercialisht jo-tërheqëse.
- Nxitja e sigurisë së rrjeteve dhe informacionit në linjë me rregullat e BE për sigurinë kibernetike

2. Nxitje e konkurrences se ndershme ndermjet operatoreve te rrjeteve dhe ofruesve te shëbimeve

- Pershpejtimi i procesit per permbylljen e raundit perkates se Analizave te tregjeve dhe percaktimin e detyrimeve proporcionale.
- Identifikim i qarte dhe ne kohe i sjelljeve strategjike te operatoreve te Operatoreve me fuqi te ndjeshme ne tregjet perkatese dhe vecanerisht per cmimet pajustificueshmerisht te uleta
- Analize e situates me kompensimet ndermjet operatoreve rishikim i masave rregullatore ne kete drejtim.
- Garantimi i Integriteti i te dhenave qe raportohen nga operatorët. Grumbullim edhe nga burime alternative dhe krahasim me praktiken me te mire te industrise.

3. Perfitimet per konsumatoret

- Portim brenda 24 orësh
- Mbeshtetja e veprimtarive te qeverise per Roving zero me vendet fqinje dhe ulje e ndjeshme e tarifave roaming me vendet e Bashkimit European
- Pershpejtimi i procedurave per fillimin e operimit te skemes se Sherbimit Universal
- Mbrojtje e kujdeshme per perdoruesit me te ardhura shume te uleta.
- Perqendrimi i perpjekjeve per arritjen objektiveve broadband (30mbit/sec per 100% te popullsise dhe 100 mbit/sec per 50% te popullsise).
- Integriteti i te dhenave te pajtimtarit; rishikim i situates ekzistuese dhe sigurimi i saktësisë së plote të te dhenave të pajtimtareve.
- Mbulimi me shërbim celular në zona me dendësi të ulët dhe rritja e cilësisë së shërbimeve
- Masa për garantimin e Shërbimit Universal postar dhe cilësisë së shërbimeve postare

4. Efikasiteti i brendshem AKEP dhe partneritet me institucionet

- Garantimi i funksionimit ligjor dhe institucional te AKEP. Vleresim i nevojës per amendime te legjislacionit.
- Rritja e metejshme e kapaciteteve strategjike, menaxheriale dhe teknike te stafit te AKEP.
- Funksionim i hapur dhe transparent ne perputhje me praktiken me te mire rregullatore te BEREC/ERGP dhe vendeve te BE
- Bashkepunim i ngushte dhe arritje e koherences se plote me rregullatorin ex-post, AK, dhe KMK
- Kontribut per rishikimin e strategjise broadband per perfshirjen e aksesit broadband ne objektin e sherbimit universal

II.2 Veprimet specifike

Ky seksion përmban një përshkrim të prioriteteve strategjike dhe veprimeve specifike që do të ndërmerren nga AKEP gjatë vitit 2018, sipas fushave përkatëse kryesore.

Fusha 1: Kushte të favorshme për investitorët

1.1. Rregulla të qarta dhe të qendrueshme për zhvillimin e infrastruktures së broadband

Ligji i ri nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”, miratuar më datë 24 Nëntor, 2016 ka për qëllim të lehtësojë dhe promovojë ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike. Ky ligj rregullon aksesin në infrastrukturën e operatorëve të rrjeteve të sektorëve në industri të tjera, i cili mund të përdoret për rrjetet e komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë.

Megjithatë, dispozita specifike të këtij ligji mbeten ende për t’u adresuar nëpërmjet hartimit të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, që përfshijnë në veçanti procedurat për dhënien e të drejtave të kalimit dhe koordinimin e punimeve civile ndërmjet operatorëve të rrjeteve dhe organeve vendore. Ministria ka raportuar planet për përfundimin e miratimit të akteve nënligjore në vitin 2018, në bashkëpunim të ngushtë me AKEP.

Me qëllim sigurimin e një ndikimi maksimal në sektorin e komunikimeve elektronike të masave për reduktimin e kostove të broadband, dhe për të mbështetur Ministrinë në përgatitjen e strategjisë së rishikuar të sektorit të TIK dhe zbatimin e planit kombëtar të zhvillimit të broadband. Qasja e AKEP për këtë çështje, është krijimi i një grupi pune të përbërë prej investitorëve kryesorë të sektorit (duke përfshirë operatorët ekzistues të rrjeteve dhe atyre potencialë) për të vlerësuar përgjigjet e tyre ndaj masave të propozuara për reduktimin e kostos së broadband. Gama e masave është e gjerë, duke përfshirë përdorimin e përbashkët të infrastrukturës, ndërtimin e përbashkët, koordinimin e punimeve civile dhe aksesin në objektet në ndërtim.

1.2. Promovimi i investimeve në infrastrukturën e fibrave optike.

Me qëllim promovimin e investimeve efçente në infrastrukturën broadband, AKEP ka krijuar një regjistër elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike (një ATLAS bazuar në platformën Eeb GIS), i cili përmban informacion mbi rrjetet publike të komunikimeve, facilitetet e komunikimeve elektronike, kabllot nëntokësore dhe transmetuesit radio). Ky informacion sigurohet nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit, të cilët kanë akses online në regjistrin

elektronik. Megjithatë, në praktikë, ATLAS aktualisht shërben vetëm për përdorim të brendshëm të AKEP, ndërsa aksesimi i operatorëve të rrjeteve kufizohet në informacionin që ata kanë dhënë për infrastrukturën e tyre. Gjatë vitit 2018, AKEP do të përmirësojë Atlasin elektronik dhe funksionet e tij, duke e zhvilluar atë më tej në një Pikë të Vetme Informacionit (SIP) të hapur për përdorim nga të gjithë aktorët e interesuar për të marrë informacion të përditësuar mbi infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike.

Në terma më afat-gjatë (përtej vitit 2018), AKEP duhet të përfshijë në këtë regjistër elektronik edhe informacion mbi infrastrukturën pasive të rrjeteve të sektorëve të tjerë të industrisë, të përshtatshëm për shpërndarjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike.

1.3. Përshpejtimi i procedurës për caktimin e spektrit të disponueshëm, që është i përshtatshëm për shërbime broadband.

AKEP synon të kryejë procedurën e tenderit për dhënien e spektrit 800 MHz (DD1) për shërbimet broadband të lëvizshme, gjatë vitit 2018. Strategjia dhe procedurat përkatëse për dhënien e spektrit të frekuencave në 700 MHz (DD1) për shërbimet broadband të hartohen pas vitit 2018.

1.4. Mbështetja e iniciativave për zhvillimin e broadband në zonat komercialisht jo-tërheqëse.

AKEP do të vazhdojë të monitorojë përmbushjen e detyrimeve të marra nga Albtelecom, Telekom Albania dhe Vodafone Albania për mbulimin me shërbime broadband të zonave me dendësi të ulët të popullsisë dhe për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar në fusha të tjera deri në fund të vitit 2018.

Në terma më afat-gjatë, AKEP mund të marrë në konsideratë gjithashtu mundësinë për të përfshirë detyrime për mbulimin e zonave rurale, në kontekstin e dhënies së spektrit 700 MHz për broadband-in celular.

Së bashku me Ministrinë, AKEP duhet të shqyrtojë mundësinë e prezantimit të skemave të financimit publik për broadband-in rural.

1.5. Promovimi i sigurisë së rrjetit dhe informacionit, në përputhje me rregullat e BE-së për sigurinë kibernetike.

Në vitin 2018, AKEP do të monitorojë masat që janë ndërmarrë dhe zbatimit të tyre nga operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike për të mundësuar sigurinë dhe integritetin e

rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, që kanë të bëjnë kryesisht me parandalimin e ndërprerjeve të shërbimit apo avarive (ndërprerjet e shërbimit).

AKEP gjithashtu mund të konsiderojë nxjerrjen apo rishikimin e udhëzimeve për operatorët lidhur me kërkesat e sigurisë bazuar në rekomandimet e ENISA dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Fusha 2: Promovimi i konkurrencës së drejtë dhe të ndershme midis operatorëve

2.1 Përshpejtimi i procesit për përmbylljen e raundit të radhës për Analizat e Tregut, dhe vendosja e masave proporcionale ndaj sipërmarrësve me FNT

Gjatë pranverës së vitit 2018, AKEP do të përfundojë analizën e tregut të terminimit të thirrjeve celulare, duke reflektuar ndryshimet e fundit në strukturën e tregut pas daljes së operatorit të katërt të rrjetit të telefonisë së lëvizshme.

Deri në fund të vitit 2018, AKEP do të kryejë raundin radhës së analizës së tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse dhe tregjeve me shumicë të aksesit broadband në rrjetet fikse. Analiza e tregut broadband duhet të përfshijë një segmentim më të hollësishëm të tregjeve sipas dimensionit gjeografik, duke reflektuar ndryshimet në kushtet e konkurrencës së tregut në të gjithë vendin, me mundësinë për të aplikuar masa më të targetuara dhe proporcionale.

2.2 Identifikimi në kohë i sjelljeve strategjike anti konkurruese të operatorëve me FNT me vëmendje të veçantë ndaj çmimeve anomalisht të ulëta, si element i kësaj sjelljeje.

Për t'u trajtuar si pjesë e analizës së tregut në vitin 2018 apo masave të tjera, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin e Konkurrencës dhe autoritete të tjera si Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit për praktikatat e pandershme tregtare.

2.3 Analize e situatës me kompensimet ndërmjet operatorëve dhe rishikim i masave rregullatore në këte drejtim

Gjatë vitit 2018 AKEP do të kryejë vlerësim të situatës së marrdhënieve midis operatorëve për aksesin dhe interkoneksionin për thirrjet hyrëse kombëtare dhe ndërkombëtare dhe impaktin e tyre në konkurrencën në tregjet përkatës me pakicë si dhe adresim të tyre në procese analizave të tregut në vitin 2018 ose në procese të vecanta.

2.4 Përmirësimi i cilësisë së të dhënave të dorëzuara nga operatorët në AKEP për analizat e tregut dhe proceset e vendimmarrjes. Nisja e mbledhjes së të dhënave nga burime alternative (duke përfshirë edhe nga ana e kërkesës) dhe krahasimin me praktikatat më të mira të industrisë.

Analizë më e hollësishme e tregut gjeografik duhet të mundësohet, bazuar në atlasin e infrastrukturës të zhvilluar nga AKEP. Mund të konsiderohen dhe metoda të tjera, të tilla si anketat me përdoruesit fundorë. Gjatë vitit 2018 AKEP do të verifikojë dhe saktësojë të dhënat

depozituara nga operatorët duke përdorur burime të ndryshme verifikimi, do të rrisë detajimin e publikimit të të dhënave. Njëkohësisht AKEP do të rrisë bashkëpunimin me INSTAT bazuar në MOU të nënshkruar në Dhjetor 2017 si dhe të përdorë sondazhe për të grumbulluar të dhanë për tregun në anën e kërkesës (demand side data/surveys).

Në një periudhë më afatgjatë, AKEP do të shikojë mundësinë e përdorimit të software specifik për statistikat (për depozitim dhe përpunim të të dhënave statistikore).

Shtylla 3: Përfitimet e konsumatorit

3.1 Mundësimi i një procesi efektiv të bartjes së numrit brenda 24 orëve

Gjatë pranverës së vitit 2018, AKEP do të hartojë ndryshimet në rregulloret dhe procedurat aktuale lidhur me portabilitetin e numrit, me qëllim mundësimin e një procesi portimi krejtësisht efektiv brenda 24 orëve. Për të lehtësuar procesin, informacioni lidhur me numrin që i është dhënë një pajtimtari do të lidhet me numrin unik personal të identifikimit të pajtimtarit dhe jo me të dhënat e emrit/mbiemrit të tij që shpesh shkruhen gabimisht dhe si pasojë vonojnë ose pezullojnë procesin e portimit.

Gjithashtu AKEP do të rivlerësojë rregullat dhe procedurat e portabilitetit të numrit, në konsultim me palët e interesuara të industrisë për sa i përket shkaqeve të vlefshme për refuzimin e një kërkesë në pritje për portim, dhe aspekte të tjera të lidhura që mund të pengojnë procesin e portimit: p.sh. veprimet për ruajtjen dhe mbajtjen, ose praktikat e përdoruar nga operatorët dhënë për të rifituar pajtimtarët.

Gjatë vitit 2018, AKEP do të ndjekë nga afër punën e BEREC mbi modelin standard të kontratave të konsumatorëve për shërbimet e komunikimeve elektronike. Në veçanti, AKEP do të studiojë mundësinë për të kërkuar përfshirjen e dispozitave për kompensimin e konsumatorëve nëse shërbimi i ofruar nuk përputhet me kushtet dhe afatet e miratuara. Këto dispozita do të zbatohen edhe për vonesat në portimin e numrit, dhe në një afat më të gjatë, edhe në situata të tjera kur cilësia e shërbimit është nën nivelin e rënë dakord në kontratë.

Në vijim të ndryshimeve që od miratohen për portimin e numrit, AKEP do të rishikojë dhe akte të tjera si formularët e regjistrimit të pajtimtarëve dhe termat e përgjithshme të kontratës së pajtimit.

3.2 Mbështetja e veprimtarisë së qeverisë për tarifën zero të roaming me vendet fqinje, dhe reduktim të ndjeshëm të tarifave roaming me vendet e Bashkimit Evropian.

Në vitin 2018, AKEP do të ndërmarrë hapa proaktivë në drejtim të lehtësimit të heqjes së roaming-ut me vendet fqinje të Ballkanit Perëndimor. Qasja e preferuar është nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe me secilin vend. Ky proces do të kërkojë konsultim me aktorët përkatës dhe vlerësimin e ndikimit të reduktimeve të tarifave për operatorët celularë.

3.3 Përshpejtimi i procedurave për nisjen e operimit të skemës së Shërbimit Universal

Dispozitat për shërbimin universal në ligjin e komunikimeve elektronike deri tani nuk janë zbatuar në praktikë. AKEP është duke ndjekur nga afër propozimet e KE-së në kontekstin e rishikimit të vazhdueshëm të kuadrit rregullator të BE-së, dhe synon të përqendrojë punën e tij për skemën e shërbimit universal drejt një shërbimi universal broadband të përballueshëm. Kjo duhet të realizohet bazuar në informacionin e hartës së infrastrukturës, të mbështetur nga atlas i infrastrukturës, i cili duhet të ndihmojë në identifikimin e zonave ku nuk ofrohet shërbim i mjaftueshëm, ku shërbimi universal nuk mund të sigurohet sipas kërkesës së tregut dhe ku masat rregullatore të shërbimit universal mund të justifikohen.

Njëkohësiht AKEP do të ndërmarrë masa për saktësimin e të dhënave të pajtimtarëve në bazat e të dhënave të operatorëve dhe masa për disponibilitetin e numeratorit telefonik dhe shërbime të kerkimit të informacionit në numerator (DIS)

3.4 Mbrojtje e kusjdeshme për përdoruesit me të ardhura të ulëta

Për të mbështetur përdoruesit me të ardhura të ulëta dhe për të lehtësuar futjen e shërbimeve me brez të gjerë, AKEP do të bashkëpunojë me qeverinë për të zhvilluar një skemë subvencioni që do të fokusohet në disponueshmërinë e kompjuterëve dhe pajisjeve fundore që mundësojnë aksesin funksional në Internet.

3.5 Përqendrimi i përpjekjeve për arritjen e objektivave të broadband (30 Mbps për 100% të popullsisë dhe 100 Mbps për 50% të popullsisë)

Harta e infrastrukturës e zhvilluar nga AKEP duhet të mundësojë monitorimin e progresit në arritjen e objektivave të broadband dhe iniciativat e mundshme të financimit publik.

3.6 Integriteti i të dhënave të pajtimtarëve; rishikim i situates ekzistuese dhe mundësim i saktësisë së plotë të të dhënave të pajtimtarëve.

AKEP parashikon masa të mëtejshme në lidhje me mbrojtjen dhe integritetin e të dhënave të konsumatorëve të ruajtura nga operatorët. Operatorëve do ti kërkohej gjithashtu të verifikojnë saktësinë e të dhënave të pajtimtarëve. Rregullat specifike procedurale do të hartohen gjatë vitit 2018: p.sh. mundësia për të konfirmuar numrin e identifikimit (Numrin Personal) nëpërmjet SMS, ku konsumatori duhet t'i përgjigjet SMS-it për të konfirmuar.

Ndërmjet nismave të tjera për mbrojtjen dhe fuqizimin e konsumatorit, AKEP synon të zhvillojë një *call center* për konsumatorët, me qëllim adresimin e ankesave të tyre dhe monitorimin e

rregullt të arsyeve kryesore të ankesave të konsumatorëve. AKEP gjithashtu do të krijojë një portal miqësor ndaj përdoruesit, për konsumatorët në faqen e tij të internetit.

3.7 Mbulimi me shërbim celular në zona me dendësi të ulët dhe rritja e cilësisë së shërbimit

Gjatë vitit 2018 AKEP do të monitorojë zbatimin e detyrimeve të operatorëve celularë sipas kushteve të autorizimeve individuale me qëllim rritjen e mbulimit dhe cilësisë së mbulimit në zonat që kanë probleme me signalin/shërbimet celulare (mungesë mbulimi ose cilësi e ulëtmbulimi/sinjali). Gjithashtu, AKEP gjatë vitit 2018 do t'i kushtojë rëndësi të vecantë detyrimeve për cilësisë e shërbimeve (QoS) duke publikuar dhe të dhëna krahasuese të QoS sipas operatorëve, përfshirë për tregues të mbulimit, shpejtësisë së aksesit në Internet etj.

Hapi tjetër, përtej vitit 2018, do të jetë zbatimi i dispozitave për cilësinë e shërbimeve dhe shpejtësinë e internetit në kontratat e konsumatorëve në përputhje me dispozitat e Rregullores së BE-së 2015/2120 (Rregullorja TSM). Si pjesë e këtij procesi, AKEP duhet të marrë në konsideratë zbatimin e një mjeti për monitorimin e shpejtësisë së shërbimit broadband, i cili mund të përdoret për të fuqizuar konsumatorët në mosmarrëveshjet e tyre me ISP-të lidhur me shpejtësinë e internetit broadband.

3.8 Masa për garantimin e Shërbimit Universal postar dhe cilësisë së shërbimeve postare

Ligji i ri 46/2015, “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i miratuar në përputhje të plotë me Direktivën Postare, ka për qëllim kryesor liberalizimin e plotë të tregut të shërbimit postar. Në këtë kontekst, ligji i ri ka përcaktuar heqjen e plotë të përdorimit të zones së rezervuar nga operatori publik si një formë mekanizmi për kompensimin e kostove për sigurimin e shërbimit universal postar. Në referim të kuadrit të ri ligjor dhe nënligjor që rregullon sektorin postar, kompensimi i kostove që mund të përbëjnë barrë të padrejtë për operatorin publik i cili ofron shërbimin universal postar, mund të sigurohet në tre mënyra: nga fonde publike, fondi i industrisë për SHU nga ofruesit alternative të shërbimeve postare apo një kombinim i tyre.

E drejta e kompensimit për koston neto të ofruesit të shërbimit universal postar lind atëherë kur AKEP-i, pas verifikimit të kryer sipas ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se ofrimi i shërbimit universal postar shkakton kosto neto shtesë, që përbën një ngarkesë të padrejtë financiare për ofruesin e shërbimit universal postar.

Natyrisht, operatori publik që të mund të kompensohet me një nga mënyrat e lartpërmëndura, do të duhet të përfundojë procesin e ndarjes së llogarive dhe të kryejë llogaritjen e kostove neto, me qëllim mundësimin e vlerësimit të AKEP për konfirmimin ose jo të kostove reale (neto). Konkretisht, mbetet e nevojshme adresimi i kësaj çështjeje brënda vitit 2018, me qëllim sigurimin e vazhdueshëm të shërbimit universal postar.

Rishikimi i kuadrit rregullator me qëllim garantimin e shërbimeve me cilësi të lartë dhe një mbrojtje më të mirë të përdoruesve të këtyre shërbimeve:

Sigurimi i shërbimeve cilësore dhe mbrojtja e përdoruesve është një kërkesë për të gjithë ofruesit e shërbimeve postare (shërbim universal ose jo). Ofruesit e shërbimeve postare duhet të përshtasin procedurë të thjeshta dhe jo të kushtueshme për përdoruesit dhe ankesat e tyre, në veçanti në rastet e humbjes së dërgesave, vjedhjes, demtimit të tyre apo mosrespektimin e standardeve të cilësisë së shërbimit. Përdoruesit duhet të jenë të garantuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve si dhe marrjen e rimbursimit dhe/ose kompensimit në rastet e demtimit humbjes së objektit postar, element këto të cilët duhet të reflektohen qartësisht në aktet nënligjore të AKEP. Nisur dhe nga fakti se pranë AKEP thuajse nuk paraqitet asnjë ankesë lidhur me shërbimin postar, është e nevojshme që brenda vitit 2018 të rishihen dhe të thejshëzohen procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si dhe një rritje e rolit të AKEP për ndërgjegjësimin e përdoruesve mbi të drejtat e tyre.

Ndjekja e procedurave për caktimin e ofruesit të shërbimit universal postar në vitin 2020.

Ligji i ri për shërbimin postar, ka dhënë operatorit publik ekskluzivitetin për të ofruar shërbim universal postar deri në vitin 2020. AKEP me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr.2581, datë 22.06.2015, sipas parashikimit ligjor, ka pajisur operatorin publik me Autorizimin Individual për ofrimin e shërbimit universal postar me afat pesë vjeçar. Duke pasur në vëmendje afatet e parashikuara në ligj lidhur me caktimin e ofruesit të shërbimit universal postar, AKEP do të duhet të përcaktojë pas vitit 2018, nëpërmejt zhvillimit të analizës së tregut, nëse ka apo jo të paktën dy ose më shumë ofrues që mund të ofrojnë shërbim universal postar, si dhe të konstatoi nëse ky shërbim ofrohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe për të gjitha shërbimet që përfshijnë SHU. AKEP në 2018 do duhet të vazhdojë bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me qëllim hartimin dhe miratimin e draft VKM-së për caktimin e procedurave të konkurrimit për përcaktimin e ofruesit të shërbimit postar.

Shtylla 4: Efienca e brendshme e AKEP dhe partneriteti me institucionet

4.1. Garantimi i funksionimit ligjor dhe institucional të AKEP. Vlerësimi i nevojës për ndryshime në legjislacion.

Ndryshimet në legjislacion do të hartohen në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë. Një nga aspektet që duhet adresuar janë dispozitat mbi kapacitetin institucional të AKEP-it, për të siguruar që ai të ketë burimet e nevojshme për të kryer detyrat e tij. Në këtë kontekst, në mënyrë që AKEP të mund të mbajë staf të kualifikuar, duhet të rivlerësohen skemat e tij të kompensimit, duke propozuar më shumë fleksibilitet për AKEP-in, për të miratuar nivele pagash që barazohen më shumë me ato të kompanive private në sektorin e telekomunikacionit. Gjithashtu mund të jetë e nevojshme të miratohen dispozita për "periudhat e qetësimit", duke parashikuar kompensimin e duhur për stafin e AKEP-it që largohet nga institucioni, të cilët gjatë këtyre periudhave nuk duhet të punësohen nga kompanitë e rregulluara.

Në terma afat-gjatë, AKEP mund të duhet të vlerësojë, në bashkëpunim të ngushtë me organet përkatëse qeveritare, efektivitetin e mekanizmit aktual të apelimit ndaj vendimeve të AKEP-it. Procedurat gjyqësore të gjata dhe joefikase, ku vendimet shpesh bazohen thjesht në zbatimin e procedurës, dhe jo në meritat e rastit, cenojnë ndjeshëm sigurinë rregullatore dhe ligjore, dhe mund të jetë e nevojshme të adresohen si pjesë e një reforme më të gjerë institucionale.

4.2. Rritje e mëtejshme e kapaciteteve strategjike, menaxheriale dhe teknike të stafit të AKEP-it.

Fokusi duhet të jetë në programet e duhura të trajnimit dhe skemat e zhvillimit të kompetencave për stafin e AKEP, dhe për të siguruar që informacioni dhe njohuritë e fituara kur stafi merr pjesë në konferenca apo trajnime, të shpërndahen midis kolegëve të tyre.

Për të përmirësuar efikasitetin e brendshëm të AKEP, mund të nevojitet krijimi i grupeve specifike të punës, për të mbajtur marrëdhënie pune aktive me BEREC. Rishikim i mënyrës se si i delegohen përgjegjësitë autoriteteve të tjera në rast se AKEP nuk është autoriteti përgjegjës.

Njëkohësiht gjatë viti 2018 AKEP do të shikojë mundësinë e përmirësimit të software për menaxhimin financiar të AKEP me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë financiare të tij.

4.3. Veprimtari e hapur dhe transparente në përputhje me praktikën më të mirë rregullatore të BEREC/ERGP dhe vendeve të BE

Rregullat dhe procedurat e brendshme të AKEP për organizimin e konsultimeve publike duhet të rishikohen gjatë vitit 2018, me fokus identifikimin e aktorëve kyç për t'u përfshirë në konsultimet

që lidhen me vendimet e AKEP-it. Gjithashtu, çdo ndryshim në procedurat e konsultimit që ndiqen nga sektorë të ndryshëm brenda AKEP-it duhet të minimizohet, duke synuar për rregulla më të harmonizuara dhe më të qarta. Në lidhje me bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në BEREC/ERGP AKEP do të përcaktojë grupe specifike pune për pjesëmarrje aktive.

4.4. Bashkëpunimi i ngushtë dhe arritja e koherencës së plotë me rregullatorin ex-post, AK dhe Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit

Bashkëpunimi ndërmjet AKEP dhe AK duhet të forcohet, nëpërmjet takimeve periodike si dhe nëpërmjet nënshkrimit të një marrëveshje të re (MOU) mes dy autoriteteve, me fokus në ndihmën reciproke dhe shkëmbimin e informacionit, si dhe ndarjen e qartë dhe transparente të detyrave.

AKEP duhet gjithashtu do të krijojë një marrëveshje të ngjashme bashkëpunimi me Autoritetin e Mbrojtjes së Konsumatorit.

4.5. Dhënie kontributi në rishikimin e strategjisë broadband për përfshirjen e aksesit broadband në objektin e shërbimit universal.

Me qëllim sigurimin e një impakti pozitiv maksimal në sektorin e komunikimeve elektronike të masave për reduktimin e kostove të broadband, dhe për të mbështetur Ministrinë në përgatitjen e strategjisë së rishikuar të sektorit të TIK dhe zbatimin e planit kombëtar të zhvillimit të broadband. Qasja për AKEP do jetë që ndër të tjera të krijohet një grup pune i përbërë prej investitorëve kryesorë në sektor (duke përfshirë operatorët ekzistues të rrjeteve dhe atyre potencialë) për të vlerësuar përgjigjet e tyre ndaj masave të propozuara për reduktimin e kostos së broadband. Gama e masave është e gjerë, duke përfshirë përdorimin e përbashkët të infrastrukturës, ndërtimin e përbashkët, koordinimin e punimeve civile dhe aksesin në objektet në ndërtim.

Gjithashtu AKEP do të bashkëpunojë me Bankën Botërore dhe palët e interesuara në projektin e BB: *Balkans Digital Highway*.

ANEKS 1: PLANI I VEPRIMIT TË AKEP PËR VITIN 2018

Fushat Kryesore	Prioritetet Strategjike	Veprime Specifike	Rezultate të Pritshme
Kushte te favorshme per Investitorët	1.1 Rregulla te qarta dhe te qendrueshme ne kohe per zhvillimin e infrastruktures së hapur broadband.	<ol style="list-style-type: none"> Mbështetje dhe bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për rishikimin e strategjisë së TIK, planit kombëtar Broadband dhe akteve nën-ligjore për Ligjin 120/2016 për zhvillimin e rrjeteve broadband të shpejtësisës së lartë Krijimi i një grupi pune me përfqsues nga investitorët kryesorë të sektorit për të bashkëpunuar në hartimin e masave për reduktimin e kostove të rrjeteve broadband 	<ul style="list-style-type: none"> Miratimi i Akteve nënligjore të për Ligjin 120/2016 Miratimi i masave për përdorimin e përbashkët të infrastrukturës, ndërtime të përbashkëta midis investitorëve, korrëdinin i punëve civile dhe akses në facilitetet e rrjeteve në ndërtesa (in-building)
	1.2 Nxitja e investimeve ne infrastrukturen me Fiber Optike.	<ol style="list-style-type: none"> Përditësimi i Atlasit Elektronik të AKEP për përmirësimin e informacionit për rrjetet e k.elektronike, funksionalitetet e tij. Përfshirja në Atlas e informacionit të rrjeteve të tjera të utiliteteteve sipas ligjit 120/2016 (Single Information Point (SIP)) Longer term: përfshirja në Atlas e informacionit për infrastrukturën pasive 	<ul style="list-style-type: none"> Zgjerim i mbulimit me rrjete me fibra optike të territorit të RSH Akses në Atlas për palët e interesuara Nxitje e përdorimit të përbashkët të infrastrukturës.
	1.3 Pershpejtimi i procedurave per venien ne dispozicion te operatoreve te spektit te pershtatshem per sherbimet broadband	<ol style="list-style-type: none"> Kryerja e procedurave për alokimin e spektrit 800 MHz (DD1) për shërbime broadband celulare Longer term: strategji per clirimin dhe alokimin e brezit 700 MHz (DD2) për shërbime broadband celulare 	<ul style="list-style-type: none"> Rritje e eficesnsës së përdorimit të radio-frekuencave Përmirësim i mbulimit dhe cilësisë së shërbime broadband nga rrjete celulare
	1.4 Mbeshtetja e iniciativave per zhvillim broadband ne zonat komercialisht jo-tërheqëse.	<ol style="list-style-type: none"> Monitorimi i zbatimit të detyrimeve të ndërmarra nga tre MNO-të për mbulimin me shërbime broadband nga rrjet celulare sipas vendimeve të AKEP 2646-2648/3.12.2015. 	<ul style="list-style-type: none"> Zgjerimi i zonave dhe përmirësimi i cilësisë së mbulimit të shërbimeve celulare broadband Masa promovuese për rritjen e

Fushat Kryesore	Prioritetet Strategjike	Veprime Specifike	Rezultate të Pritshme
		<p>9. Bashkëpunimi i AKEP me organet e pushtetit lokal për lehtësimin e proceseve të lejeve përkatëse për ndërtim infrastrukture broadband sidomos në zonat e pambuluara me rrjet celular</p>	cilësisë së shërbimit broadband
	<p>1.5 Nxitja e sigurisë së rrjeteve dhe informacionit në linjë me rregullat e BE për sigurinë kibernetike</p>	<p>10. Monitorim i vazhdueshëm i masave të marra nga operatorët dhe zbatimit të tyre për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve të k.elektronike sipas Rregullores Nr.37 të AKEP.</p> <p>11. Longer Term: udhëzime të AKEP për operatorët për kërkesat për sigurinë e rrjeteve sipas rekomandimeve të ENISA dhe praktikave më të mira ndërkombëtare</p>	<p>- Rritje e sigurisë së rrjeteve dhe integritetit të rrjeteve të k.elektronike për të ulur sidomos rastet e ndërprerjeve të shërbimeve</p>
<p>Nxitje e konkurrencës së ndershme ndërmjet operatoreve të rrjeteve dhe ofruesve të shërbimeve</p>	<p>2.1 Përsheptimi i procesit për permbylljen e raundit përkatës së Analizave të tregjeve dhe përcaktimin e detyrimeve proporcionale. Analizat e tregjeve vetëm me të dhëna të filtruara të operatoreve të cilat duhet të reflektojnë situatën reale.</p>	<p>12. Përfundimi i procesit të analizës së tregut celular dhe vendimeve për përkatëse të FNT</p> <p>13. Kryerja e procesit të analizës së tregut të telefonisë fikse për tregjet përkatës të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve</p> <p>14. Procesi i analizës së tregut broadband duke përfshirë një analizë më të detjuar për segmentim gjeografik të tregjeve përkatës</p>	<p>- Masa rregullatore proporcionale për nxitjen e konkurrencës efektive midis operatorëve dhe përfitimeve të përdoruesve të shërbimeve celulare</p> <p>- Masa rregullatore proporcionale në tregjet përkatës broadband dhe telefonisë fikse, përfshirë mundësinë e segmentimit gjeografik të tregjeve përkatës.</p> <p>- Rritje e përdorimit dhe përfitimeve nga aksesit broadband fikse</p>
	<p>2.2 Identifikim i qarte dhe në kohë të sjelljeve strategjike të operatoreve të Operatoreve me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse dhe veçanërisht për cmimet pajustifikueshmerisht të ulëta</p>	<p>15. Forcimi i bashkëpunimit me AK nëpërmjet takimeve periodike</p> <p>16. Adresim i sjelljeve antikonkurruese nëpërmjet analizave të tregut që do kryhen gjatë vitit 2018 dhe/ose masave të tjera në bashkëpunim me</p>	<p>- Shmangje/dënim i sjelljeve antikonkurruese dhe konkurrencë më efektive në treg</p>

Fushat Kryesore	Prioritetet Strategjike	Veprime Specifike	Rezultate të Pritshme
		AK dhe KMK	
	2.3 Analize e situates me kompensimet ndermjet operatoreve rishikim i masave regullatore ne kete drejtim	17. Analizë e situatës së marrdhënieve midis operatorëve për aksesin dhe interkoneksionin për thirrjet hyrëse ndërkombëtare dhe impaktin e tyre në konkurrencën në tregjet me pakicë të k.elektronike 18. Adresim në analizat përkatëse të tregut gjatë vitit 2018	<ul style="list-style-type: none"> - Konkurrencë më efektive në treg - Mbeshtetje me zgjidhje ne kohe optimale ne rast mosmarrveshjes midis operatoreve
	2.4 Garantimi i integritetit të të dhënave qe raportohen nga operatorët.	19. Cross-checking i të dhënave të raportuara nga operatorët duke përdorur burime të ndryshme 20. Rritje e detajimit të të dhënave të publikuara nga AKEP (sipas operatorëve) 21. Rritje e bashkëpunimit me INSTAT 22. Grumbullim të dhënash për tregun nëpërmjet sondazheve (demand side) 23. Longer term: Software për statistikën	<ul style="list-style-type: none"> - Monitorim sistematik në distancë i të dhënave - Përmirësim i cilësisë së të dhënave të raportuara, publikimeve si dhe vendim-marrjes së AKEP
Perfitimet per konsumatoret	3.1 Portim brenda 24 oresh	24. Rishikimi i rregullores së Portabilitetit 25. Rishikim i akteve të tjera rregullatore që ndikojnë te portabiliteti: <ul style="list-style-type: none"> o Formaluaret e regjistrimit të pajtimtarëve o Rregullore për termat dhe kushtet e kontratës së pajtimit 	<ul style="list-style-type: none"> - Lehtësim i procedurave për portim - Mundësim portimit të numrit brenda 24 orëve - Përdormi i Numrit Unik Personal si mjet identifikimi i pajtimtarëve . - Amendim i termave të përgjithshme të kontratave për për të përfshirë kompensim për pajtimtarin nga operatori për problemet me portimin

Fushat Kryesore	Prioritetet Strategjike	Veprime Specifike	Rezultate të Pritshme
	<p>3.2 Mbeshtetja e veprimtarive te qeverise per Roaming zero me vendet fqinje dhe ulje e ndjeshme e tarifave roaming me vendet e Bashkimit European</p>	<p>26. Takime bilaterale me autoritetet rregullatore homologe të vendeve të rajonit për inisiativa konkrete për reduktimin dhe më tej eliminimin e tarifave të roamingut në rajon</p> <p>27. Marrveshje bilaterale/multilaterale me vendet e rajonit për roamingun</p> <p>28. Konsultime me operatorët celularë për reduktimi deri në heqjen e tarifave roaming me vendet e rajonit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Rritje e përfitimeve të konsumatorëve/bizneseve nga përdorimi i shërbimeve jashtë vendit (roaming ndërkombëtar) - Nënshkrim MOU me rregullatorë të vendeve të rajonit
	<p>3.3 Përshtetimi i procedurave për fillimin e operimit të skemës së Shërbimit Universal</p>	<p>29. Identifikimi nëpërmjet informacionit të Atlasit për zonat pa shërbim broadband ku SHU nuk mund të ofrohet në baza komerciale nga tregu</p> <p>30. Ndërmarrja e masave për disponibilitetin e numëratorit telefonik, DIS dhe saktësimi i bazës së të dhaneve të operatorëve për pajtimtarë</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ofrim dhe/ose rritje e përdorimit të aksesit broadband në zonat jo-atraktive - Fillimi i ofrimit të shërbimeve të numëratorit dhe DIS - analize e kostos së implementimit të rregullave për një raportim të detajuar dhe në baze sistemeshe
	<p>3.4 Mbrojtje e kujdesshme për përdoruesit me të ardhura shumë të ulëta</p>	<p>31. Bashkëpunim me Qeverinë për të krijuar një skemë subvencionimi për përdoruesit me të ardhura të ulëta duke u fokusuar në pajisjen e tyre me PC dhe/ose pajisje të tjera fundore për akses në internet</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Reduktim/eliminim i përjashtimit dixhital për shtresat në nevojë me të ardhura të ulëta
	<p>3.5 Përqendrimi i përpjekjeve për arritjen e objektivave broadband (30mbit/sec për 100% të popullsisë dhe 100 mbit/sec për 50% të popullsisë)</p>	<p>32. Pasurimi dhe saktësimi i informacionit për hartën e infrastrukturës për rrjetet broadband (Atlas) me qëllim monitorimin e arritjes së objektivave broadband dhe mundësimin e inisiativave për financim publik</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Rritje e përdorimit të shërbimeve broadband dhe ICT dhe cilësisës së tyre

Fushat Kryesore	Prioritetet Strategjike	Veprime Specifike	Rezultate të Pritshme
	<p>3.6 Integriteti i te dhenave te pajtimtarit; rishikim i situates ekzistuese dhe sigurimi i saktetise se plote te te dhenave te pajtimtareve</p>	<p>33. Rregulla/procedura specifike per verifikimin nga operatorët të të dhënave identifikuese të pajtimtarit, përfshirë Numrin Personal</p> <p>34. Ri-konfigurimi i faqes ëeb të AKEP për ta bërë sa më të përdorshme (user-friendly) për konsumatorët.</p> <p>35. Longer term: call centre per trajtimin e nakesave të pajtimtarëve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Saktësimi i të dhënave të pajtimtarëve - zgjidhja e mosmarrveshjeve dhe trajtimi i ankesave të pajtimtarëve ne menyre efektive
	<p>3.7 Mbulimi me shërbim celular në zona me dendësi të ulët dhe rritja e cilësisë së shërbimeve</p>	<p>36. Monitorimi i zbatimit të detyrimeve të operatorëve celularë për mbulimin me shërbime sipas kushteve te autorizimeve individuale</p> <p>37. Monitorimi QoS, shpejtësisë aksesit në Internet dhe publikimi nga AKPE i të dhënave krahasuese për cilësinë e shërbimeve</p> <p>38. Longer Term: zbatimi i një mjeti për monitorimin e shpejtësisë së shërbimit broadband, i cili mund të përdoret për të fuqizuar konsumatorët në mosmarrëveshjet e tyre me ISP-të lidhur me shpejtësinë e internetit broadband</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e cilësisë së mbulimit dhe shërbimeve të rrjeteve celulare - Rritje e transparencës për përdoruesit fundorë për shërbimet e ofruara nga operatorët dhe cilësisë së shërbimeve të tyre - Rritje e konkurrencës në treg për cilësinë e shërbimit
	<p>3.8 Masa për garantimin e Shërbimit Unversal postar dhe cilësisës së shërbimeve postare</p>	<p>39. Përfundimin e proçedurave lidhur me implementimin e mekanizmit të ri të kompensimit të kostove të shërbimit universal</p> <p>40. Bashkëpunim me Ministrinë e Infratsrukturës dhe Energjisë për hartimin e proçedurave per caktimin e ofruesit të shërbimit universal postar ne vitin 2020</p> <p>41. Rishikimi i kuadrit rregullator me qëllim garantimin e shërbimeve me cilësi të lartë dhe një mbrojtje më të</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Akte nenligjore për procedura të caktimit të ofruesit të SHU për shërbimin postar - Përlllogaritja e kostove neto të SHU postar - Rritje e cilësisë dhe përfitimeve nga shërbimi postar

Fushat Kryesore	Prioritetet Strategjike	Veprime Specifike	Rezultate të Pritshme
		mirë të përdoruesve të këtyre shërbimeve	
Efikasitet i brendshëm AKEP dhe partneritet me institucionet	4.1 Garantimi i funksionimit ligjor dhe institucional të AKEP. Vlerësim i nevojës për amendime të legjislacionit.	42. Bashkëpunim me Ministrinë e Infrastukturës dhe Energjisë për amendimet përkatëse ligjore, për të garantuar kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe pavarësinë financiare të AKEP, trajtimin financiar të stafit etj. 43. Longer term: bashkëpunim me organet përkatëse për të vlerësuar efektivitetin e apelimit të vendimeve të AKEP	- Rritje e pavarësisë financiare të AKEP
	4.2 Rritja e metejshme e kapaciteteve strategjike, menaxheriale dhe teknike të stafit të AKEP	44. Pjesëmarrje e stafit në programe të duhuara trajnimi si dhe ndarje e informacionit 45. Përmirësimi i software të menaxhimit financiar të AKEP	- Rritje e cilësisë dhe efikasitetit të punës së AKEP
	4.3 Funksionim i hapur dhe transparent në përputhje me praktiken më të mirë rregullatore të BEREC/ERGP dhe vendeve të BE	46. Krijimi i grupeve specifike të punës për pjesëmarrje aktive në BEREC/ERGP 47. Standardizim i procesve të keshillimit publik në lidhje me publikimin e komenteve dhe qëndrimin ndaj tyre 48. Publikimi në muajin Dhjetor i Planit të Veprimit të AKEP për vitin pasardhës duke rritur dhe shkallën e përfshirjes së palëve të interesuara në proces	- Rritje e bashkëpunimit me BEREC/ERGP - Rritje e transparencës dhe përgjegjshmërisë së AKEP

Fushat Kryesore	Prioritetet Strategjike	Veprime Specifike	Rezultate të Pritshme
	<p>4.4 Bashkëpunim i ngushtë dhe arritje e koherences se plote me rregullatorin ex-post, AK dhe Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorit</p>	<p>49. Forcimi i bashkëpunimit me AK nëpërmjet takimeve periodike 50. Nënshkrimi i një MOU të ri me AK 51. Rritje e bashkëpunimit me KMK për adresimin e praktikave pandershme tregtare të operatorëve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Adresim në mënyrën dhe kohën e duhur i sjelljeve antikonkurruese me masa ex-ante dhe ex-post
	<p>4.5 Kontribut për rishikimin e strategjisë broadband, për përfshirjen e aksesit broadband në objektin e Sherbimit Universal.</p>	<p>52. Bashkëpunim me Ministrinë e Infrastukturës dhe Energjisë në proceset përkatëse të rishikimit të startegjisë broadband 53. Krijimi i një grupi pune me përfqsues nga investitorët kryesorë të sektorit për të bashkëpunuar në hartimin e masave për reduktimin e kostove të rrjeteve broadband 54. Bashkëpunim me Bankën Botërore dhe palët e interesuara në projektin e BB: Balkans Digital Highway</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Masa konkrete për zgjerimin e infrastukturës broadband në Shqipëri - Rritje e bashkëpunimit rajonal për infrastukturën broadband